



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802512/7

Tiranë ___/___/2019

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave për ekzekutimin plotësisht dhe pa vonesë të Vendimit Gjyqësor nr. 576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.*

Marrjen e masave për të zbatuar efektivisht detyrimin e përcaktuar sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Civile dhe dhe përcaktimeve të kryera në dispozitivin e Vendimit Gjyqësor nr. 576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Drejtuar : **Mikeda Cenaj**
Kryetare e Zyrës së Përmbarimit

KURBIN

Për dijeni : **Xh.J.**
Adresa :

KURBIN

Zj.Kryetare!

Në mënyrë të përsëritur shtetësja Xh.J. ka prezantuar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit shqetësimin e moszekutimit të titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor nr.576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me objekt :

“Detyrimin e të paditurve R.K., K. Xh, K.C të pushoj cënimin e pronësisë së paditëses duke hequr depozitat 1000 litërshe dhe bazamentin ku mbështetet këto depozita.

Detyrimin e të paditurve R.K., K. Xh, K.C të shpërblejnë paditësen me vlerën 157.980 lekë në mënyrë solidarë.

Detyrimin e të paditurve R.K., K. Xh, K.C të riparojnë taracën sipas situacionit të punimeve të paraqitura në aktin e ekspertimit që ndodhet në dosje”

Pra, sikurse konstatohet, Zyra e Përmbarrimit, Kurbin, prej afro nëntë vitesh, nuk ka arritur të ekzekutoj detyrimet e vendosur ndaj gjyqbjerrësve për heqjen e depozitave nga tarraca e godinës ku ata banojnë së bashku me gjyqfituesen.

Në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, për dhënie informacioni dhe shpjegimesh, rreth shkaqeve të cilat justifikojnë mosekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Tiranë, ju zj. Kryetare, me Tuajën nr.771 Prot, datë 13.02.2019, pas një ekspozije për situatën në të cilën është ndodhur dhe ndodhet kjo çështje, shpreheni se:

“Në vijim, me lajmërimin nr.423 prot, datë 05.02.2019, kemi lajmëruar për aplikim sanksioni për mosekzekutim ndaj palës së tretë J (Gj.P) dhe kemi njoftuar palët e treta N.S., H dhe S.P, :

- *se depozitat 1000 litërshe të ujit që ata kanë për përdorim dhe të cilat janë vendosur në tarracën e katit të IV-të të banimit në pallatin nr.136, lagj nr.1, Kurbin, janë objekt ekzekutimi prej Zyrës së Përmbarrimit, Kurbin, në çështjen*
- *se në zbatim të urdhërit të ekzekutimit nr.430/364, datë 29.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kurbin, Brenda 10 ditësh nga marrja dijani e njoftimit përmbarrimor, duket të heqin depozitat 1000 litërshe, të vendosura mbi tarracën e katit të IV-të të banimit në pallatin nr.136, lagja nr.1, Kurbin, depozita këto që sipas konstatimeve të bëra në procesverbalin e dates 25.01.2019, janë në përdorim apo pronësinë e tyre si palë e tretë dhe të cilat si sende të luajtshme dhe të paregjistruara me dokumentacion përkatës duhet të hiqen në mënyrë që të pushohet cënimi i pronësisë në zbatim të titullit ekzekutiv nr.1144-966, datë 22.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kurbin, ndryshuar me Vendimin nr. nr. 576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Tiranë, të dhënë në favor të pales kreditore Xh. J.*

Veprimi i fundit përmbarrimor i kryer në dosje është përsëritja e kërkesës për mbështetje për punëtor ndaj Bashkisë, Kurbin, me nr.767 prot, datë 12.02.2019, kërkesë kjo që i është përcjell për dijani edhe palës kreditore XH.J. dhe sapo të na sigurohet mbështetja me punëtor dhe hidraulik nga Bashkia, Kurbin, do të procedohet me caktimin e datës për ekzekutimin në objekt ekzekutimi për të ekzekutuar tërësisht urdhërin ekzekutiv nr.430/364, datë 29.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kurbin”.

Për zgjidhjen e çështjes të prezantuar prej ankueses Xh.J, konstatojmë, se, është konsumuar dhe po konsumohet energji joefektive prej Zyrës së Përmbarrimit, Kurbin.

Kryerjen e veprimit përmbarrimor për lajmërimin e palës së tretë, me shkresën nr.423, datë 05.02.2019, nuk e gjejmë të mbështetur në ligj, dhe konsiderohet si një kuptim dhe zbatim i keq i parashikimit të kryer në nenin 606 të K.Pr.C. Ushtrimi i kompetencë për vendosjen e sanksionit ndaj gjyqëbjerrësve apo personave të tretë mund dhe duhet të ndodh në kushtet e parashikuara në këtë dispozitë ligjore, dhe asnjëherë me paralajmërimet zyrtare.

Për heqjen e dispozitave të ujit, sikurse vendosur nga Gjykata, ju zj. Kryetare, shpreheni se, me shkresën nr.767, datë 12.02.2019, keni kërkuar ndihmën Bashkisë, Kurbin, për vënien në dispozicion të punonjësit hidraulik, dhe se me marrjen e mbështetjes do të caktoni ditën për heqjen e depozitave. Kjo kërkesë juaja gjen mbështetje në nenin 30/2 të

ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor”*, por nisur nga detyrimi i organeve shtetërore dhe publike për dhënien e ndihmës, ju do të duhet të përcaktoni datën dhe orën e kryerjes së veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e detyrimit ndaj gjyqëbjerrësve si dhe kërkesën drejtuar Bashkisë, Kurbin, për dërgimin në këtë datë të punonjësit sipas profesionit përkatës.

Gjithashtu, ju z. Kryetare, nuk keni mbajtur parasysh parashikimin e kryer në nenin 605 të K.Pr.C., në të cilin thuhet se:

“Kur debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, që ka të bëjë me një veprim që mund ta kryejnë edhe persona të tjerë, kreditori mund të kërkojë nga përmbarruesi gjyqësor që të lejohet ta kryejë vetë këtë veprim për llogari të debitorit”.

Në komunikimin e kryer me ankuesen Xh.J, ajo është shprehur, se, mund t'i gjej vetë punëtorët për heqjen e depozitave, rrethan kjo, e pamarrë parasysh nga ana juaj në referim të dispozitës ligjore të sipërcituar.

Zyra e Përmbarrimit, Kurbin, prej Vitit 2010, ka kryer procedura për ekzekutimin e titullit ekzekutiv të lartpërmendur, por nuk ka realizuar deri më sot materializimin e së drejtës të fituar prej ankueses në rrugë gjyqësore.

Veprimtaria e Zyrës së Përmbarrimit, Kurbin, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. 576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit, Tiranë, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Në nenin 320/a të Kodit Penal parashikohet se, vepra penale *“Mosekzekutimi pa shkaqe të përlligjura i vendimit të gjykatës”*,

kryhet me mosveprim për mosekzekutimin pa shkaqe të përlligjura të vendimit të gjykatës penale ose civile. Shkaqe të përlligjura janë ato të sëmundjes së përmbarruesit, vdekje ose fatkeqësi tjetër familjare ose forcë madhore. Kur mungojnë këto shkaqe të përlligjura, personi i ngarkuar ka përgjegjësi penale për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Gjithashtu nisur nga parashikimi i kryer në nenin 31, dhe 35/dh të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor”*, i ndryshuar, gjykojmë se, qëndrimi i mbajtur prej cilitdo përmbarruesi gjyqësor të çështjes në procesin e ekzekutimit të Vendimit nr. 576, datë 30.03.2010, ka përbërë shkak për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, për inicimin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij, sikurse parashikuar në nenin 35/dh të këtij ligji.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problem, çmon me vend të rekomandoj kryerjen e veprimeve përmbarrimore të cilat mundësojnë rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur ankueses.

Për arsyet e përmendura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin sanksionohet, se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë*

rekomandime dhe të propozoje masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Marrja e masave për ekzekutimin plotësisht dhe pa vonesë të Vendimit Gjyqësor nr. 576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Marrjen e masave për të zbatuar efektivisht detyrimin e përcaktuar sipas parashikimeve në në Kodin e Procedurës Civile dhe dhe përcaktimeve të kryera në dispozitivin e Vendimit Gjyqësor nr. 576, datë 30.03.2010, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA (CANAJ)

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**